

FERIT LAMAJ

ZEMËRQESHUR

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8 SH-1
L20



Poezi satirike

85H-1

L 20

FERIT
LAMAJ

ZEMËRQESHUR

poezi
satirike

~~13179~~
13179

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

ZEMËRQESHUR

Sot, në festën e Çlirimit,
kur dhe plaku bëhet djalë
i drejtohem xha Selimit
dhe me të këmbej dy fjalë:

— Shqipëria është veshur
në flamurë e në dritë...
Më përgjigjet zemërqeshur:
— Si lum ne për këto ditë!

— Edhe kohën e merhumit
ke jetuar, xha Selim,
ndaj në festën e Çlirimit
ca kujtime... — Nipi im!...

Xha Selimi llullën nxjerr
dhe ashtu i urtë, i qetë
nis e fjala fjalën merr,
unë veshët, fësht, përpetë.

— ...Qysh pa gdhirë të vinte beu
e të thoshte: Ej, fshatar!
Erdha unë, s'më sheh, pa ngrehu,
më jep borxhin që ke marrë.

Dhe pas tij, me vrap të tjerë,
taksidari e xhandari...

— Po, ç'të mbetej? — Si përherë
ty të mbetej... strumbullari.

— Po kur dergjeshe sëmurë?
...Për t'u shtruar në spital
sa para jepje për kurë?
— Asnjë dyshkë, more djalë.

— Si kështu, o xha Selim,
nuk shpenzoje asnjë lek?!
— Nuk shpenzoja, more trim:
...s'kish spitale e as kish mjek.

— Dhe të drejta kishit vallë?
— Kishim një sa për njëzet...
— Po ç'qe kjo? — Sa të qemë gjallë
të mos kishim një të drejtë.



Por të keqen na e mori
kohë e skamjes dhe urisë
se një ditë erdhi Nëntori,
erdh' Nëntori i Lirisë.

METJA KA ZEMËR BUJARE

Brigadieri ynë Mete
nuk e ka shokun gjetiu,
t'i qan hallet si për vete,
është' i mirë, shpirt njeriu.

Ke probleme familjare...
Mos prish gjakun, byrazer;
Metja ka zemër bujare,
do t't'i zgjidhë menjëherë.

Metja është deli burrë,
ia, dhe Sulës ia zgjidh hallin
pasi ditën e mërkurë
një komshi fejoka djalin!



Një sebep ka dhe Fuati:
nesër mbrëma i vijnë miq
nga qyteti e nga fshati, —
i ka pjellë lopa viç.

Por dhe Ceni ka një hall
se në drekën e së shtunës
kushëriri i tij i shtatë
na i vënka emrin çupës.

Halle paskan dhe të tjerë
Sala, Sela edhe Nisi,
shoku Mete zemërgjerë
dhjetë leje i qëndisi.

I qëndisi bukuri
dhjetë leje urgjentisht
edhe pse në...logari
dita ecën normalisht...

GABIMISHT

Hekurani mbrëmë vonë
vu ca hekur përmbi shpinë...
Gabimisht e vu, me ç'thonë,
pse ta prishim terezinë!

Teli sonte më të gdhirë
gabimisht ca tel na merr,
ti ç'më thua, ta shkund mirë?!
...T'ia falim këtë herë.

Xhepi nesër nja dy gozhdë
mund të na i fusë në xhep,
një nga ju pastaj do thotë:
As vërejtje s'po i jep?

Jo se jam ca zemërgjerë,
por në punë, miku im,
bëjm' gabime që të tërë
apo kam ndopak gabim?



— Edhe unë të jap hak
për çka thua, mik vëllai,
ti, gabim nuk ke aspak:
...S'ke gabim sepse ke... faj.

SHOKU SHEF

Shoku shef, dëgjova sheshit
shum' e shum' fjalë për ty,
por unë dyllë i vura veshit
dhe e mbylla njërin sy...

Eh, sa lodhesh nëpër shkresa,
të shkojn' djersë në fytyrë...
Shoku shef, kush ka ankesa,
nuk di ç'halle ke në zyrë!...

Shoku shef, ata që thonë...
s'dinë ç'halle ke në zyrë!
Bile qumësht të takon
se ke sobën me... qymyr!

Nuk iu pa një her' fytyra
në brigadë, seç më thanë.
...Por ti, shef, i sheh nga zyra
arat, vreshtat dhe meranë.

Por ti, shef, i sheh nga zyra
arat, vreshtat dhe meranë,
misrin, grurin ngjyra-ngjyra:
ke dritare nga çdo anë...

Në brigadë s'dukesh fare... (!)
...S't'i dinë hallet, andaj thonë,
por ti ke katër dritare,
veç... dylbia të mungon...

Shoku shef, pa ec në lëmë,
ec në fushë e në serrë,
ta dëgjojm' si e ke zënë
se s'ta ndiem kurr' një herë.

Shoku shef, pa shih kur korrim,
kur prashisim, hedhim farë
...se në zyrë ku je kyçur
s'di ç'është: dimër a behar!...

PLOT TET' ORË KUR... FLE GJUMË...

Kam një fqinjë në pallat,
ia thon' emrin Agathi;
për çdo ditë poshtë e lart
na tjerr llafet në seri.

Fqinja jon' e rafinuar
mban në gojë tërë një qytet,
di kush është pa martuar,
kush ka gaz e kush siklet.

...More vesh?... Për një gjilpërë
u zu Tana me Vojsavën,
ndërsa Sania e mjerë
na u nda pa mbushur javën.



Ësht' gjinkallë edhe mizë,
...Le ta themi midis nesh:
kur fillon të dërdëllisë
duhen pasur tri palë veshë.

Ndaj sa herë që në shtëpi
për vizit' vinte xha Loni
na thosh ne me qesëndi:
s'paska ardhur... gramafoni?

Kot, për nder, ia nxorën bojën:
«I derdh llafet porsi lumë»
...Me sa di, ajo kyç gojën
plot tet' orë kur... fle gjumë...

TYMOS BYRAZERI QË NGET NË TIMON

«Ndalohet duhani!», thosh një etiketë
në autobusin e linjës filan,
mirëpo ja që tymi shkoka përpjetë
dhe pse udhëtarët nuk pijnë duhan!

Po nga vjen ky tym që si re noton?!
...Tymos byrazeri që nget në timon...

KONTROLLI DHE SELIMI

Kontroll paska ardhur, bobo ç'befasi!
E fiku Selimin, e fiku,
e ka magazinën pa lyer ai,
plot pluhur, pa poç elektriku.

O burra, një fshesë! Po kova ku ndodhet!
Nxiton posht' e lart i hutuar,
o burra, o burra sa shumë sot po lodhet
me zell u dashka punuar.

Si s'paska mëshirë kontroll i uruar,
pse erdhi kaq shpejt, rrufe!
Të paktën, Selimin ta kish lajmëruar
një javë më parë, dy apo tre...

~~78889~~
13179



MIRKETËS

E mban veten, moj Mirketë,
sikur ke zbritur nga retë.
Ne, s'do mend, e dimë sekretin:
...ke mbaruar fakultetin.

Si të flasësh me ne shtruar,
ke diplomë, je e zgjuar!
Ndaj sa herë që na ndesh,
ironike buzëqesh.

Ja seç desha të të them
nëpërmjet këtyre shkronjëve:
Buzëqeshjen le ta kesh
midis nesh, jo midis... thonjëve!

1977 - 1978 - 1979 - 1980 - 1981 - 1982 - 1983 - 1984 - 1985 - 1986 - 1987 - 1988 - 1989 - 1990 - 1991 - 1992 - 1993 - 1994 - 1995 - 1996 - 1997 - 1998 - 1999 - 2000 - 2001 - 2002 - 2003 - 2004 - 2005 - 2006 - 2007 - 2008 - 2009 - 2010 - 2011 - 2012 - 2013 - 2014 - 2015 - 2016 - 2017 - 2018 - 2019 - 2020 - 2021 - 2022 - 2023 - 2024 - 2025

1. Në fillim të viteve 1970-ve, në mesin e popullit, u shfaqën shprehjet e urrejtjes së fortë ndaj diktaturës staliniste dhe ndaj politikave të dështuara të regjimit komunist. Këto shprehje u shprehën nëpërmjet këtyre shkronjëve: Buzëqeshjen le ta kesh midis nesh, jo midis... thonjëve!

2. Në fillim të viteve 1980-ve, në mesin e popullit, u shfaqën shprehjet e urrejtjes së fortë ndaj diktaturës staliniste dhe ndaj politikave të dështuara të regjimit komunist. Këto shprehje u shprehën nëpërmjet këtyre shkronjëve: Buzëqeshjen le ta kesh midis nesh, jo midis... thonjëve!

3. Në fillim të viteve 1990-ve, në mesin e popullit, u shfaqën shprehjet e urrejtjes së fortë ndaj diktaturës staliniste dhe ndaj politikave të dështuara të regjimit komunist. Këto shprehje u shprehën nëpërmjet këtyre shkronjëve: Buzëqeshjen le ta kesh midis nesh, jo midis... thonjëve!

4. Në fillim të viteve 2000-ve, në mesin e popullit, u shfaqën shprehjet e urrejtjes së fortë ndaj diktaturës staliniste dhe ndaj politikave të dështuara të regjimit komunist. Këto shprehje u shprehën nëpërmjet këtyre shkronjëve: Buzëqeshjen le ta kesh midis nesh, jo midis... thonjëve!

5. Në fillim të viteve 2010-ve, në mesin e popullit, u shfaqën shprehjet e urrejtjes së fortë ndaj diktaturës staliniste dhe ndaj politikave të dështuara të regjimit komunist. Këto shprehje u shprehën nëpërmjet këtyre shkronjëve: Buzëqeshjen le ta kesh midis nesh, jo midis... thonjëve!

PORSI ORATOR PO FLET MJEK SELMANI

Porsi orator po flet mjek Selmani
për dëmet e shumta që shkakton duhani...

Leksioni ka nisur ka nja dy-tri orë
e në këtë çast seç u ngrit një dorë:

— Me leje, doktor, kam një propozim!
Meqë shkoi gjatë... bëjmë ca pushim?

— Po, po, — than' të tjerë, — e ka mirë Ceku! —
Pastaj sërish fjalën na e mori mjeku:

— Bëjmë një pushim të vogël fare
sa... të pimë nga një cigare...



EDHE NGJALA NGEC NË RRJETË

Don të qepësh pantallona
a këmishë privatisht?
Buzagaz të pret Dodona,
në të errur, natyrisht.

Kot, për nder, ta kanë inatin,
kot të mbajn' në gojë gratë,
ti e dashuron zanatin,
ndaj punon gjer në mesnatë.

Kur dikush troket te porta,
ti kollaj s'bie në çark,
i merr masat mjaft të forta
...Sheh oborrin rreth e çark.

I merr masat energjike,
je si ngjalë, s'zihesh lehtë,
por dhe ngjala, o moj mike,
ndodh që ngec dikur në rrjetë...

SEÇ NA ERDHI FQINJ I RI

Seç na erdhi fqinj i ri,
s'është' si ti e s'është' si unë;
që ditën e parë atij
i rrihte zemra për punë...

Me çekan, e daltë, e sharrë
nisi punën fqinji im,
duhej ndrequr dhom' e parë,
duhej bërë modifikim.

Bam e bum çekan e daltë,
u prish muri në një orë;
fqinji s'të lënka në baltë,
fqinji qenka murator!...

— Ç'po dëgjoj, si pompë më ngjan!
— Pompë është' mos bëj çudi,
fqinji po lyen tavanë,
fqinji ështëë bojaxhi!..

— Po kjo çezmë që shkon krua!
— S'është çezmë, more mik,
fqinji po bën skaldabanjë,
fqinji është' hidraulik!..

Sh-sh-sh sharron një sharrë,
dhe një zdrug e ndjek nga pas,
marangoz na qenka fqinji,
fqinji gdhend edhe dërrasë!...

— Ç'patën dritat, pse u prenë!
— Mos u tremb, hej miku im,
dritat i ka prerë fqinji
se do bëjë një instalim!..

E mor fqinj, ç'më le pa mend
me zanatet në seri!
Por më parë nevoj' për daltë
edhe zdrug na paske ti...

SEKRET

— A e di ku është halli,
unë e di që ti s'e di,
është sekret, ta marrë djalli,
ndaj askujt veç unë e ti...

T'i thashë rrënjët e sekretit,
tani diç më mundon mua:
ndoshta Metit dhe Bexhetit
si padashur ua thua...

Metin ballë për ballë e ndeshi:
— E di çfarë, dëgjo, o Met!
Do t'të them diçka te veshi,
veç sekret se... është sekret!

E bën fjal' dhe me Bexhetin,
meqë qenkan miq të vjetër,
— ...Veç kujdes, ruaj sekretin!
Unë, ti dhe askush tjetër!...



A s'më thua, byrazer:
po ç'sekret qenka ky vallë
kur shetit derë më derë
edhe merr shtatë mëhallë!...

MOJ BEHARJA JONË E RE

E mbaroi shkollën fare,
jo shaka, shtatëmbëdhjet' vjet,
dhe tani shoqja Behare
një behar ka që po pret,

që po pret të nisë nga puna
në Tiranë me çdo kusht
se në Shkodër vërshon Buna
e në Dibër e ka ngushtë.

Se në Pukë e Bajram Curr
borë ka, shi e të ftohtë,
nuk do të pranonte kurrë
as në Lezhë e në Milot...

**Moj Beharja jonë e re,
ti ke dalë mjeke në jetë:
e si do na shërosh ne,
kur qenke sëmurë vetë?...**

SHOKU SOFO

Shoku Sofo na ish bërë
kok' e këmbë burokrat,
nuk e pam' një vit të tërë
të na vijë në brigadë.

Nuk e pam' tërë një vit
të na vijë në brigadë —
kishe hall ti ndonjë ditë,
të përcillte për më lart.

...Shokut Sofo na i thanë
të ler' zyrën përgjithmonë,
të ler' dosje, shkresa ç'janë,
të shohë tokën tek prodhon.

Shoku Sofo deli burrë
do të hedhë pleh në arë,
me një drapër do korr' grurë,
do prashisë e do hedh' farë!



Shoku Sofo deri dje
fjalët «farë» dhe «plehërim»
na i hidhte si më nge
veç në letër pa përtim!

Mirëpo ja që erdhi dita
(kjo dit' do vinte patjetër),
miku të na hedh' në arë
atë çka hodhi në letër...

O BURRA, NJË BURRË

Ja, çupa na mbushi njëzet sivjet
e kemi në shkollë të lartë,
...O burra, një burrë në kryeqytet,
që çupës t'i vejë për shtat.

Ne çupën e kemi në shkollë të lartë,
ndaj mbrapa nuk kthehemi kurrë,
detyrën të tërë e kemi të qartë:
oburra, oburra, një burrë.

Dhe qark seç u nisën këtu e atje
në gjurmë të dhëndrit të ri —
babai i çupës, pas tij dy a tre,
në fund dhe një kushëri.

Nja dhjet' propozime u hodhën në fletë,
por kjo qenka punë e vështirë:
...në shoshë t'i fusim me ngut që të dhjetë,
të zgjedhim kush është më i mirë.

Se çupën e kemi të pakrahasuar
me trupin e drejtë selvi,
me gushën e ballin e sytë e shkruar
e mendjen e ndritur flori.

...Flori e kish mendjen ajo me t'vërtetë,
u tha: — Më kot lodhi për mua,
se shokun e zemrës unë do ta zgjedh vetë
që shumë' të më dojë dhe ta dua...

NGA REGJIMI DITOR I NJË VJEHRRE

Ja regjimi im ditor:
zgjimi fiks në orën pesë,
çantën marr në njërën dorë
edhe nisem pa vonesë.

Shpejt e shpejt e pa vonesë
duhet vajtur në dyqan:
duhen blerë arr' e vezë
dhe një kile patëllxhan.

Patëllxhane, vez' e arrë
ja, i shpura në shtëpi,
mirëpo qumështi s'është marrë
ndaj do nisur përsëri.



Veç të shihni sa m'ka hije
kur nxitoj për te kasapi:
se, siç më tha një komshie,
paska dalë sot mish cjapi.

Gjmnastikës së mëngjesit
nuk i jap jo fund me kaq
se akoma s'kam marrë preshin
edhe dy kile spinaq.

Por sërish duhet shpejtuar,
pasi ora po shkon shtatë,
e në çerdhe duhet çuar
nip' i vogël Eduard...

Ja dhe nipin shpura unë
sipas planit të regjimit,
ju do thori: «Ke më punë?»
...Kam procesin e gatimit.

Ja, tryeza është shtruar
supë, mish e gjell' gjithfarë,
por furnella s'duhet shuar:
do vën' ujë për të larë.

Rrobat laj, bëj drek' e darkë
dhe shtëpinë fshij me fshesë,
unë kam nuse për merak
e për të nuk kam ankesë

Se detyrat nusja ime
i ka ndarë «barabar»
...Ajo bën tet' orë në punë,
në shtëpi unë pa orar...

.. DHE NGA REGJIMI DITOR I NJË NUSEJE

Thash' të flija nja dy orë
pasi mbrëmë qesh' turn i tretë,
më zu gjumi në çast... por
nuk më la vjehrra të qetë.

Nuk më la vjehrra të qetë,
nisi sulmin si ngaherë:
— Nuk e sheh sahatin tetë
ç'bën akoma, moj e mjerë!

Çohu, moj, ç'të paska gjetur
që nga shtrati s'më lëviz!
Nuk të mora për të fjetur,
por për punët e shtëpisë.

Nuse, shpejt e shpejt ndiz zjarrë
edhe mos më rri si hu,
nuse, rrobat duhen larë,
dyshemeja gjithashtu.

Si të fshihet mirë tavani,
gjëkund pluhur të mos mbesë,
shko një vrap dhe nga dyqani
për sallam e mish e vezë.

— Kur do çlodhem pakëz vallë?
Se ja, erdhën edhe drutë;
lart e poshtë nëpër shkallë,
vjuhërr, mesi m'u këput!

S'të vjen turp, moj e uruar!
Lëre, moj, dhëmbjen e mesit,
verë xhezven pa vonuar
e sill kafen e mëngjesit.

Çirret rishtaz ime vjuhërr,
zë i saj si në shtatë puse;
fjal' e saj urdhër i prerë:
nuse, nuse, nuse, nuse...

Ja dhe kohën ta kam ndarë:
drekë e dark' për të gatuar,
për të fshir' e për të larë,
për të qepur e arnuar.

Katër orë apo pesë
ndoshta jan' dhe ca si shumë,
kohën tjetër që të mbesë
bëje çlodhje edhe gjumë.

Bëje çlodhje edhe gjumë,
shko në film a në teatër;
pra, siç sheh s'të lodha shumë,
po të mbajta fort me hatër.

Po vërtet më mban me hatër
...Mbledhjen bëra prej fillimit:
shuma, orë njëzet e katër
por... pa orët e pushimit.

Ç'faj pra ka, vjehërr e gjorë,
fajin ti e ke, natyrë,
që s'i dhe ditës ca orë
që t'i çlodh këto gjymtyrë...




DASHURI

— Un' të njoh. Në s'më njeh ti,
kjo nuk ka shumë rëndësi.
Ah, ta dish se sa të dua,
dil e pyet ti për mua...

Dil e pyet në të tjerë
kam a s'kam frigorifer,
do të gjegjen si në korr:
«ka edhe televizor».

Un', moj xhane, kam tri dhoma,
që të tria mbushur plot
me minderë e kuverta
që rrallkush i ka në botë.



Kam dhe perde të mëndafshta,
kam fustane në seri,
dhe qilimat e kolltukët
i kam bler', o shpirt, për ty...

E ç'të pyesësh, moj xhane,
merr një bllok për të shënuar:
...Inventar i shtëpis' sime
është i gjatë, s'ka të mbaruar.

Le të thon' gojët e liga
se un' qenkam i moshuar;
gojëve u rëntë pika
që veç flasin pa pushuar.

Un' vërtet, moj bukuroshe,
dyzet vjet i mbush tani,
porse ndjenjat s'i kam boshe
ndaj dhe ndihem djal' i ri...

— Ç'djal i ri, të marrt' e mira,
qysh më ndihesh djal' i ri!
Unë sa ti, dyzet pranvera,
kam babanë në shtëpi.

MË HABITI MIKU SHUMË

Me gjithë grua për vizitë
te një shok shkova një ditë;
u llafosëm gjer' e gjatë
si ne burrat, edhe gratë...

Kam një djalë, thosh ai,
sa dhe vetë bëj çudi:
aq i shkathët e i zgjuar,
aq i urtë e i dëgjuar...

Më habiti miku shumë,
ndaj në fund e pyes unë:
— Sa vjeç është, nuk më the?
— Katër muaj mbushi dje...

NË «BOT' TË LIRË» JE MJAFT I LIRË

Në «bot' të lirë»... je mjaft i lirë
se pi e ha e ngopesh mirë...
Po me se, do thoni ju?
...Kjo s'do mend: kërbaç e dru.

Në «bot' të lirë»... të lirë jeni
ta rripni tjetrin pasi ta therni
dhe mos t'ju prishet hiç terezia:
...Ju vjen në ndihmë dhe... policia.

«Bota e lir'» është ideale,
do gjesh atje edhe spitale,
veç që të shtrohesh do thyer çeku:
e sa për ty «shërohet»... mjeku.



Në «bot' të lirë»... i lirë je
një të fitosh, të prishësh tre,
por ti s'ke faj dhe këtë herë
çmimet u ngjitkan në... stratosferë.

Për gjeometër mbaroi studimet
Sasha... dhe sot po ha premtimet.
Rrugë më rrugë punë kërkon,
pra profesionin me zell ushtron...

E ndërsa Billi në Amerikë
studimet ndoqi n'matematikë,
tashmë përmendësh bën llogarinë
se sa dollarë dha për çdo ditë.

Pra siç e shihni, o miq të mirë,
në «bot' të lirë» je... mjaft i lirë.



I VJEDHURI DHE... VJEDHËSI

Zunë një vjedhës një ndaj nate
mu në mes të Virxhinisë:

— A, ti qenke vjedhës banke, —
ia nis shef' i policisë...

— Jam i vjedhuri, — i thotë, —
e jo vjedhës siç përmende
se paratë që mora sot,
shkuan në ...kuletën tënde...

PASI NDRYSHE DO T'QE PUNA

Dy majorë amerikanë
shah po luanin njëherë...
Humbet njëri një ushtar
edhe nxehet, bëhet vrerë.

E sheh tjetri e i thotë:
— Po ti, ç'pate! Ç'djall të zuri?
Vallë, të erdhi keq, koleg,
për këtë ushtar prej druri!

E dëgjoji sa e dëgjoji
të fituarin i pari,
më në fund i kthehet ashpër:
— Tamam, ky është shkaktari.

Tamam ky është shkaktari
e që gjakun krejt ma prishi,
pasi ndryshe do t'qe puna
po të ish ushtar prej mishi...

MODË

— Ky që mban llullën përpjetë
dhe është veshur kauboj,
djali juaj është? — Njet,
është vajza, daragoj!

— Po ajo me flokë mbi supa
edhe lyer brilantinë,
pa dyshim që është çupa?
— Është djali, miku im.

— Me ç'po shoh nga veshja, ti
je i ati atëherë.
— U gabove përsëri:
Jam e ëma, byrazer...

SHAH MAT

Shahu Reza një ditë nga ditë
u tremb i shkreti siç tremben minjtë.

Na e pa veten porsi në çark,
valixhet mbushi, u nis për larg.

U nis për larg, në... Amerikë
— Bujrum, — i thanë, — të kemi mik!

Të kemi mik, or tungjatjeta,
më shumë nga koka vlen kuleta.

Miku q'është mik, njihet në hall:
ti deri dje na mbajte gjallë.

Qe mik me besë, pa zhurm' e bujë,
na e dhe naftën si të ish ujë.

Ndaj sot të mbrojmë ne me dëshirë,
pra fli i qetë... natën e mirë!

Pra fli i qetë, porse s'fle dot,
një zë i fortë ushton në botë:

Të kthehet shahu pra, sa më parë
se... llogaritë i la pa larë.

Ç'kërkon ky popull, ç'kërkon ky zë?
Për nder se vrau pa faj dhe një!

Këtu vërtet keni të drejtë:
nuk vrau një, por... mijëra vetë.

...Nuk gjen dot prehje shahu Reza,
ndaj e ndal vrullin në Panama.

Mjerisht, më fort po ushton zëri,
shahu Reza dridhet i tëri.


A ke dëgjuar, shahu Reza,
tek humbet koka kur luhet shah?

Dhe ty të pret i njëjti fat:
nuk ke nga shkon se je shah mat...

1980

PA VINI VESHIN

Pa vini veshin ndiqni fjalimin,
flasin e flasin për çarmatimin...
Vallë nga flasin me fjalë të zjarrta?
Nga Semipalatinski e Nevada...



PORSE HALL KA MISTER KLARKU

Mister Klarku ng' Amerika
është pronar në tri fabrika.

Dhjet' mijë vetë, porsì limoni
për çdo ditë i shtrydh padroni.

Shtrydh të tjerët, trashu vetë,
Mister Klark, hej jetë o jetë!

Porse hall ka mister Klarku:
Një kuintal i vajti barku...



Vetëm barku një kuintal,
shto dhe kokën... hall o hall.

Hall o hall, se ndër të tjera,
mjerisht s'na e zinte dera.

Ndaj nuk priti, por një ditë
i shkon mjekut për vizitë:

— Hello mik, bëmë derman,
shpejt më hiq ca tul e dhjamë.

Shpejt më jep pra një recetë,
pasi fryma m'u zu krejt...

I tha mjeku këto fjalë:
— Për çdo ditë shalo mbi kalë.

Për tri javë ndryshe do jesh:
do të biesh mjaft në peshë.

Mister Klarku kështu bëri:
tri javë kalin zu për frëri.

Ra në peshë?... Ra vërtet,
por jo Klarku... kali vetë...

FABULA

MILINGONA DHE MERIMANGA

Milingonëza e vogël
merimangën sheh në mur:

— Punëtore kaq të zonjën
gjer më sot s'kam parë kurrë...

— Më ngadalë se të ndien zënë, —
ia pret milingona nënë, —

merimanga është «amvisë»,
di të thurë e të qëndisë,

veç, këshillë, biri im:
mos i shkel kurrë në qilim...

DHELPRA DHE KËNDESI

Ka ca kohë,
ish mëngjes,
na sheh dhelpra
një këndes.

E ia nis
me të vajtuar:
— Miku im
i paharruar,

humba udhën
dhe shtëpinë,
më ndihmo,
paç perëndinë!

Zbrit, pra, poshtë,
o këndes...
S'ha më shpendë,
rroj me djersë...



— Rron me djersë! —
Ki-ki-ki,
qesh këndesi
mbi çati.

«Humbe» udhën
dhe shtëpinë
...Por, s'ke humbur
dhelërinë...

UJI DHE SHIU

Ndërsa shiu binte
me zhurmë e bujë,
i krenohej ujit:
— Edhe unë jam ujë.

Ndaj, vëlla i dashur,
duhet parë kjo punë:
ndryshe pritesh ti
edhe ndryshe unë!

Ndërsa ty të duan
e të pijnë me gotë,
mua s'më përfillin,
un' qenkam i kotë!

E dëgjoi uji
e i thotë prerë:
— Ja si qëndron puna,
shi, o byrazer;

Edhe ty të duan
se nuk vete dëm,
me sa di unë, bujku
të këndon dhe këngë!

Pse më pijnë veç mua?
...Ja përse më pijnë:
se përmbi të tjera
un' kam cilësinë...

PËRROI DHE MALI

— Kur shpërthej
me ujë shumë
nga përrua
kthehem lumë.

Dhe me zhurmë,
rrëmujë e fjalë
marr përpara
ç'të më dalë...

Kështu mburrej përroi
mirëpo mali e dëgjo
dhe me zë të plotë
i thotë:

— Dhe bën dëm
dhe mburrje thua,
more lumë
e... përrua!

Mënyrë e shprehur...

Shprehur në mënyrë
shprehur në mënyrë
shprehur në mënyrë
shprehur në mënyrë

Shprehur në mënyrë
shprehur në mënyrë
shprehur në mënyrë
shprehur në mënyrë

Shprehur në mënyrë
shprehur në mënyrë
shprehur në mënyrë
shprehur në mënyrë


NA I THOSH DIKUJT NJË FIK

Na i thosh dikujt një fik:
— Deri dje s'të pashë, or mik,
ndërsa sot që frutat bëra,
më vjen qark me orë të tëra...

SHIH, MOJ MIKE, PISHËN

Gardhit po i mburrej një mëngjes një ferrë:
— Gjelbërimin tim rrall' e kanë të tjerë,
rrall' e kanë të tjerë këtë bukuri
apo jo, o gardh, ç'mendim më jep ti?

E dëgjoji gardhi e në fund ia priti:
— Ty vetëm pesë muaj blerim të ka viti,
shih, moj mike, pishën që nuk flet një herë,
ndonëse jeshilon dimër edhe verë...



DITA DHE NATA

Ish janar e ndërsa nata
i thosh ditës: — Uh, e ngrata,
sa e shkurtër je... Shihm' mua!
Do ca orë t'i jap hua?

Qeshi dita: — Ha-ha-ha
për ato ç'ka nata tha, —
jam e shkurtër sot, e di:
në qershor ama je ti...

BUFI

Pula, gjeli dhe rosaku
diskutnin një të shtunë
jo e lagu, jo s'e lagu
gjersa më në fund u zunë.


Thirrën bufin e kënetës,
vajti bufi e u tha:
— Ti, or gjel, nuk ke të drejtë,
dhe rosaku të drejtë s'ka.

— Paskam unë atëherë, —
gjegji pula me një zë.
— Jo, as ti, moj byrazere,
s'ke të drejtë hëpërhë.



— Hënë, moj e zezë hënë,
—

— S'morëm vesh, o buf, po ti
askërkujt të drejtë s'i dhe!
U hodh bufi: — Miqt' e mi,
të drejtë keni që të tre...



HËNA DHE XIXËLLOJA

— Hënë, moj e zeza hënë, —
nis nga mburrjet xixëlloja, —
ku e ke vëllanë tënd,
diellin e... ta verboja.

I ka dalë nami si shumë
për ndriçim e ku di unë...

Ia pret hëna: — Xixëllojë,
thoja vetë këto fjalë
në mëngjes kur të agojë
e të duket përmbi mal.

Veç, që të mos ndizesh flakë,
një këshillë: rriji larg...



HYRA VETË

S'më zë grepi,
as dhe rrjeta;
jam si ngjalë,
or tungjatjeta.

Jam si ngjalë,
mburrej krapì,
veç një ditë
rrjeta e kapi.

Por ç'e do
se peshku krap
dhe... në rrjetë
mburrej prapë:


Mos pandehni
se në rrjetë
sot, më zunë,
jo... hyra vetë...

SKILJA DHE SHQIPJA

Skilja rrinte rëndë-rëndë,
bënte ndarjen në tri pjesë:
këtëj ujkun edhe qentë,
andej çakallin me besë.

Ty, këndes, dhe ty, moj rosë,
po ju fus në tuf' të tretë;
t'ju kem pranë e të bëj çmos
ndaj po hyj këtu dhe vetë.

Sillet skilja porsí mike,
porsí mike u qan hallin:
që të ruhen nga ujku,
të bëjn' paqë me çakallin.



Të bëjn' paqe me çakallin,
ndërsa ujkut gjakatar
me një plumb t'i bien ballit
si armik e si kusar.

I tha shqipja nga foleja
skiles lajkatare:
— Teoritë e nxjerr të reja,
por gjithnjë mbetesh tinzare...

—

1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25

Shkruar nga [illegjibël]
[illegjibël]
[illegjibël]
[illegjibël]

[illegjibël]
[illegjibël]
[illegjibël]
[illegjibël]

PËRMBAJTJA

VJERSHA

Zemërgeshur	3
Metja ka zemër bujare	6
Gabimisht	9
Shoku shef	11
Plot tetë orë... kur fle gjumë	13
Tymos byrazieri që nget në timon	16
Kontrolli dhe Selimi	17
Mirketës	18
Porsi orator po flet mjek Selmani	20
Edhe ngjala ngec në rrjetë	21
Seç na erdh fqinj i ri	23
Sekret	25
Moj Beharja jonë e re	27
Shoku Sofo	29
Oburra, një burrë	32

Nga regjimi ditor i një vjehrre	34
...Dhe nga regjimi ditor i një nuseje	38
Dashuri	41
Më habiti miku shumë	44
Në «bot' të lirë» je mjaft i lirë	45
I vjedhuri dhe vjedhësi	48
Pasi ndryshe do t'qe puna	49
Modë	51
Shah mat	52
Pa vini veshin	55
Porse hall ka mister Klarku	56

FABULA

Milingona dhe merimanga	61
Dhelpra dhe këndesi	62
Uji dhe shiu	65
Përroi dhe mali	67
Na i thosh dikujt një fik	69
Shih, moj mike, pishën	70
Dita dhe nata	71
Bufi	72
Hëna dhe xixëlloja	74
Hyra vetë	75
Skilja dhe shqipja	77